

ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së përfundimtare. 4. Katër muaj para datës zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.”

- (E) **Neni 6** parashikon se: “1. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet mosçënimimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të vecanta në legjislacionin në fuqi dhe në këtë vendim. 3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorin të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. 6. Ndalohej përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore të institucioneve, nëpërmjet ushtrimit të presionit ndaj tyre për këtë qëllim, si dhe premimit ose ofrimit të përfitimeve nëpunësve publikë, për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës.”

61. **Jurisprudenca:**

- (i) Vendimi Nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese;
- (ii) Vendimi Nr. 169, datë 26.07.2002 i Gjykatës Kushtetuese;
- (iii) Vendimi Nr. 39, datë 27.07.2015 i Gjykatës Kushtetuese;
- (iv) Vendimi Ireland v. United Kingdom, datë 18.01.1978 i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (v) Vendimi Hirst v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (vi) Vendimi Aziz v. Qipro, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (vii) Vendimi Labita v. Italy, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

- (viii) Vendimi Sitaropoulos etj. v. Greqia, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (ix) Vendimi Carr. v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (x) Vendimi S. and Marper v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xi) Vendimi Rotaru v. Rumania, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xii) Vendimi Aman v. Zvicra, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xiii) Vendimi Association "21 December 1989" and other v. Rumania, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xiv) Vendimi Nr. 45, datë 18.11.2013 i Kolegjit Zgjedhor.

III. ANALIZA LIGJORE

III.1 NË LIDHIJE ME PROCEDURËN DHE KONTËSTIMIN

A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese

62. Neni 123/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve zgjedhore në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për rështje që bëjnë pjesë në trashitë e kompetencave të KQZ-së. Ndërsa, neni 124, pika 1 dhe 3 parashikojnë se çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Pëmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.
63. Me Vendimin Nr. 72, datë 15.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 "Partia Demokratike", me Kryetar z. Lulzim Basha, me shkrimejt nistore "PD" ose "PDSIT". Ndërsa, me Vendimin Nr. 107, datë 02.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë koalicionin "Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim" ose "PD-AN", si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, të udhëhequr nga Partia Demokratike.

64. Në zbatim të nenit 123/1, pika 1 dhe nenit 124, pikat 1 dhe 3, sipërcituar, Partia Demokratike e Shqipërisë ka legjitimatio activa për të paraqitur çdo ankim, që e çmon të bazuar, kundër vendimeve të KZAZ-së apo KQZ-së. Në rastin konkret, PD ka paraqitur një ankim kundër Vendimit Nr. 344, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabeles Përmbledhëse të Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Elbasan", duke kërkuar pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Elbasan. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e parë procedural, legjitimimit aktiv, për paraqitjen e këtij ankimi.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

65. Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma "a" parashikon se KAS i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesëshmërisë së plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, pika 5 parashikon se vendimet për miratimin e Tabeles Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.
66. Me Vendimin Nr. 344, datë 04.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e Tabeles Përmbledhëse të Rezultatit në Zonën Zgjedhore Elbasan. Në zbatim të nenit 12, pika 5, nenit 21, pika 1, gërma "a" dhe nenit 123, pika 5 e Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor, ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të KQZ për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve zgjedhor në KAS, brenda afatit ligjor. Në rastin konkret, Partia Demokratike ka paraqitur një ankim kundër Vendimit Nr. 344, datë 04.05.2021, duke kërkuar pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Elbasan. Shqyrtimi i këtij ankimi është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

67. Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabeles Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 152, pika 2 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar një afat të përgjithshëm ankimi 5-ditor kundër të gjitha vendimeve të marra nga KQZ-ja në periudhën 48 orë pas deklarimit të zgjedhjeve deri në përfundimin e shqyrtimit administrativ të ankimeve. Ndërsa, neni 124, pika 3 ka

parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbljedhës të Rezultatit në Zonën Zgjedhore Elbasan mund të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

68. Në rastin konkret, vendimi Nr. 314 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është shpallur në datën 04.05.2021. Për respektimin e afatit ligjor, subjekti zgjedhor duhet të paraqesë një ankim jo më vonë se data 10.05.2021. Ankimi i PD-se është paraqitur në datën 09.05.2021, pra brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga nenet 152, pika 2 dhe 124, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.
69. **Konkluzion:** Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitetin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se siç kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga PD-ja përmbush të tre kriteret proceduriale (legjitimitetin, kompetencën dhe afatin ligjor), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

III.2 NË LIDHIJE ME THEMELIN E PRETENDIMEVE PËR PAVLEFSHMËRI

A. Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve:

70. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasujat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.
71. Për të vërtetuar (pa)ligjshmërinë e një veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cënuar rëndë procesin zgjedhor apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, KAS-i duhet të orientohet nga konceptet e perpuçura nga jurisprudenca gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit. Terminologjia “e rëndë” dhe ndikimi

“në një masë të tillë”, i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen nga KAS-i të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje (shih vendimin Nr. 45, datë 18.11.2013 të Kolegjit Zgjedhor; vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese).

72. Në rastin konkret, Partia Demokratike do të parashtojë një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre çënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Elbasan.

A.1 Shkeljet ligjore lidhur me manipulimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet blerjes së votës, përdorimit të personave me precedentë kriminalë, dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera, si shkelje të ligjit që kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor:

73. Manipulimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet pritarit, ngritja apo dhënies së përfitimeve monetare apo materiale, ashtu si edhe kërcënim i votuesve, kanë qenë problematika të theksuara që kanë shoqëruar vazhdimisht proceset zgjedhore në Shqipëri, veçanërisht në 10 vitet e fundit. Në raportet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, veçanërisht në raportet e OSBE/ODIHR, këto problematika vijnë të përsëritura dhe vazhdimisht ka rekomandime për të marrë masat e duhura ligjore dhe institucionale për luftimin e këtyre fenomeneve.
74. Për luftimin me efikasitet të këtyre fenomeneve, legjislatori shqiptar, i asistuar nga ekspertiza ndërkombëtare e partnerëve tanë, ka miratuar ndryshime të vazhdueshme në Kodin Zgjedhor, në Kodin Penal dhe akte të shumta nënligjore që synojnë pikërisht adresimin e këtyre problematikave. Konkretisht, neni 78, pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e subjekteve zgjedhore të ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, pranimje vund pune apo

- favorizime të tjera me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetje të një kandidati.
75. Ky parashikim i Kodit Zgjedhor është reflektuar më tej edhe në Kodin Penal, i cili në nenin 328 parashikon se ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar, përbën veprë penale dhe dënohet me burg nga një deri në 5 vjet. Shpeshherë praktika e shfrytëzimit të votës është e shoqëruar edhe me veprimtari të tjera të paligjshme, të tilla si marrja e dokumentit të identifikimit për të moslejuar votimin, kanksja e zgjedhësit apo detyrimi për të votuar në një mënyrë të caktuar nga një person që ushtron një funksion publik.
76. Megjithatë, ekzistenca e një legjislacioni solid për krimet zgjedhore më shumë është tregues i përmbushjes në lartë të rekomandimeve në raportet ndërkombëtare lidhur me zgjedhjet në Shqipëri, se sa një vullnet i mirëfilltë i partive politike. Megjithatë, tre partitë kryesore shqiptare (PS, PD dhe LSI) arritën një dakordësi mbi ndryshimet e Korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor, të cilat gjithësesi u pasuan nga ndryshime të tjera të njëanashme nga Partia Socialiste, fatkeqësisht edhe në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit nuk munguan rastet flagrante të shfrytëzimit të votës, dhënies së ndihmave ushqimore apo kërcënimit të votuesve nga ana e drejtuesve, përfaqësuesve apo mbështetësve të Partisë Socialiste.
77. Shkeljet flagrante të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, Kodit Zgjedhor, tërësia e veprimtarisë kriminale të kaluar gjatë periudhës zgjedhore, e dokumentuar sipas **36 provave** të këtij ankimi do të analizohen si vijon:
78. **Së pari**, sic kemi shpjeguar në pjesën e tretënave të çështjes, Partia Demokratike nepërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta flagrante të shfrytëzimit të votës. Për të gjitha këto raste, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në SPAK, ndër të cilat 30 kanë të bëjnë me raste masive të shfrytëzimit të votës dhe 130 kallëzime në prokuroritë e mirëve për shkelje të tjera. Në rastin e qarkut Elbasan, Partia Demokratike ka depozituar dy kallëzime në SPAK për mbi 40 persona, ndër ta zyrtarë të pushtetit vendor e qendror, persona me rekorde të tmerrshme kriminale, persona nën kërkim, të përfshirë drejtpërdrejtë në blerjen e votave në favor të PS. Këta persona me rekorde kriminale, drejtohen nga drejtues të lartë të institucioneve shtetërore apo Partisë Socialiste, si Taulant Balla, Suel Çela dhe personazhe të

tjerë që janë lartpërmendur dhe lidhjet e të cilëve me krimin e organizuar janë faktuar sipas provave.

79. Por, përveçse një veprimtari kriminale, e cila duhet të hetohet dhe dënohet nga organet e drejtësisë (SPAK dhe Gjykata), blerja e votës përbën shkelje të rënda të Kodit Zgjedhor, duke cenuar procesin zgjedhor, den në atë masë sa sjell pavlefshmërinë e tij në rast se faktohet shtrirja e saj në masë të gjerë. Konkretisht, neni 78, pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon shprehimisht ndalimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për të ofruar ose dhënë të holla, të mira materiale, premtime për vende pune ose favorizime të tjera të cilësdo forme, me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar ose marrjen pjesë në votime.
80. Në rastin e Qarkut të Elbasanit, kemi faktuar nëpërmjet 9 provave se persona me rekorde të tmerrshme kriminale, me një keye drejtuesin politik të PS-së, Taulant Balla, kishin ndarë zonat dhe ishin angazhuar në blerjen masive të votës dhe marrjen e kartave të ID. Kjo veprimtari ishte shtrirë si në Qytetin e Elbasanit, ashtu edhe në rrethinat e tij. Për çdo zonë vepronin grupe të caktuara kriminale, me individë të emëruar si koordinatorë apo patronazhistë, roli i tyre i vetëm ishte blerja e çdo vote të mundshme, duke përdorur pushtetin dhe influencat e tyre kriminale në zonë.
81. Kjo skemë kriminale e blerjes së votës në mënyrë masive, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Elbasanit, përbën shkelje të rënda të ligjit zgjedhor, të cilat kanë cenuar procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor, për rrjedhojë edhe në shpërndarjen e mandateve. Qartësisht, veprimtaria kriminale e blerjes së votës ka cenuar rëndë procesin zgjedhor dhe ka ndikuar thelbësisht në ndarjen e mandateve, çka do të thotë se në kuptim të neni 160 kjo duhet të sjellë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në atë zonë zgjedhore dhe përsëritjen e zgjedhjeve.
82. Së dyti, neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 3 e Vendimit Nr. 9/2020 parashikojnë se katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re para zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfutimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë ritjen e pagave, mbështetjes ekonomike, dhënien e shpërblimeve etj. Megjithatë, Qeveria në disa raste nëpërmjet vendimeve të saj akordoi shtesa në ndihmën ekonomike, dhënie shpërblimesh të posaçme, ritje pagash, fonde të posaçme për bujqësinë dhe dëmtshpërblime për familjet e prekura nga tërmeti, duke manipuluar kështu vullnetin e zgjedhësve nëpërmjet përfutimeve të drejtpërdrejta.

83. Nga ana tjetër, dhënia e një page shitesë nga drejtuesi politik i PS, Ardan Cela për 13 mijë punonjës të OSHEE është po ashtu në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së. Për numrin e sakrë të punonjësve të OSHEE në Qarkun e Elbasanit që kanë përfutur nga ky vendim, ne do të kërkojmë martjen e informacionit zyrtar si provë. Në këtë kuptim, edhe kjo vendimarrje në shkelje të ligjit, përmasat reale të të ciles do të zbulohen gjatë hetimit administrativ, ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve, cka e bën kërkesë për shpalljen e pavlefshmërisë trefish të bazuar në ligj e në prova.
84. **Konkluzioni:** Nga sa më sipër, është e qartë se ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në mënyrë kapilare në të gjithë Qarkun e Elbasanit për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve.
85. Dhënia e një page shitesë nga Ardan Cela, drejtues politik i PS-së, për 13 mijë punonjës të OSHEE-së, në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të tij, kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor. Dhënia e përfitimeve në të holla nga buxheti i shtetit ka synuar manipulimin e vullnetit të zgjedhësve në favor të PS-së. Por, përmasat reale të numrit të zgjedhësve që kanë përfutur qotë nga skema e paligjshme e Bashkisë Elbasan, ashtu nga OSHEE, do të zbulohen gjatë hetimit administrativ. Megjithatë, në çdo rast është e qartë se shkeljet flagrante të ligjit, dhe në vecanti të nenave 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, të kryer nga zyrtarë të lartë drejtues të PS-së kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë edhe ndryshimin e rezultateve zgjedhore dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Elbasanit, cka në kapim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sjell detyrimisht pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

A.2 Shkeljet ligjore lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore nëpërmjet kontratave publike, investimeve publike/rindërtimit, intimidimi i nëpunësve publikë/mbështetësve, punësimet në administratën publike

86. Një nga parimet kryesore të proceseve zgjedhore në shtetet demokratike është barazia ndërmjet palëve në garë. Ky parim është sanksionuar në nenin 1, pika 3 të Kushtetutës, i cili parashikon se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta. Por, një nga

shtat kryesore për të arritur barazinë e partive politike në garë mbetet fakti se partia në pushtet, mund të përdorë burimet e shumta që ofron shteti për t'i vënë në funksion të maksimizimit të votës së saj. Me qëllimin eliminimin apo reduktimin e këtij rreziku, që do të munte garën ndërmjet palëve, shtetet kanë implementuar rregulla të shumta që ndalojnë një sërë veprimtarish të qeverisë dhe parlamentit në periudhën përpara zgjedhjeve.

87. Shqipëria, si një vend me probleme të shumta sa i përket zgjedhjeve, vecanërisht në 10 vitet e fundit, ka vuajtur vazhdimisht nga përdorimi i shfrenuar i burimeve publike nga partia në pushtet, me qëllim të vetëm fitimit e votave nëpërmjet një sërë mekanizmesh që ka nën kontroll çdo qeveri gjatë ushtrimit të pushtetit. Për të frenuar përdorimin e burimeve publike dhe me qëllimin krijimin e rregullave të barabarta të garës, legjislatori shqiptar ka miratuar një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor dhe aktet nëligjore të tij, që ndalojnë shprehimisht kryerjen e një numri veprimtarish nga ana e qeverisë në periudhën katër muaj përpara zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re. Vecanërisht, ndryshimet e kryera në vitin 2020 në Kodin Zgjedhor u fokusuan thuajse tërësisht në adresimin e kësaj problematike, nisur nga përvoja shumë problematike e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.
88. Konkretisht, neni 78 i Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucionet publike. Më tej, ky nen parashikon ndalimin e partive ose kandidatëve për të premtuar vende pune apo favorizime të tjera, me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar. Ndërsa, neni 91 parashikon ndalimin e vënies në tubeshitje të kandidatëve, partive ose koalicioneve të burimeve të organeve apo enteve publike, në nivel qendror apo vendor, si dhe çdo burimi njerëzor. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet përdorimi i detyruar i administratës shtetërore në zgjedhje ose ofriti i përfitimeve për nëpunësit që angazhohen në zgjedhje. Pika 3 e këtij neni ndalon marrjen në punë, pushimin, lirin, lëvizjen dhe transferimin në detyrë në fushatë zgjedhore. Ndërsa, pika 4 parashikon ndalimin katër muaj para zgjedhjeve të nxjerrjes së akteve ligjore apo nënligjore që parashikojnë dhënie përfitimesh, rritje pagash, pensionesh, mbështetje ekonomike, sociale, ulje/heqje taksash, amnistie, privatizim, dhënie pasurish/shpërblimesh etj.
89. Përshkrimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor u detajuan më tej në Vendimin Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, i cili parashikon shprehimisht se çfarë konsiderohet veprimtari të ndaluara për t'u promovuar, veprimtari të ndaluara në përgjithësi dhe ndalimet e posaçme sa i përket administratës shtetërore. Qartazi, qëllimi i këtyre dispozitave është të bëjë një ndarje të qartë ndërmjet Shtetit dhe Partisë në pushtet. Kjo e fundit nuk duhet të

shfrytëzojë pozicionin e saj, natyrisht më të favorizuar, për të fituar garën ndaj partive të tjera konkurrencte nëpërmjet mbështetjes shtetërore. Në të kundërt, funksionimi si Parti-Shtet do të bënte garën thjesht një formalitet pa doli.

90. Në rastin e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit, sic kemi shpjeguar gjerësisht në pjesën e rrethanave të çështjes, faktuar me prova dhe me qëllim për të mos shmangur përsëritjet, del qartë konkluzioni që deklaroi shetja e Misionit të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR, Znj. Ursula Gacek se **në zgjedhjet e 25 prillit nuk pati një kufi të qartë ndërmjet partisë dhe shtetit**. E thënë me fjale të tjera, Partia Socialiste u soll në fushatën zgjedhore si një Parti-Shtet, duke vënë në funksion të saj të gjithë mekanizmat shtetërorë me qëllim fitimin e zgjedhjeve.
91. **Së pari**, neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para dates së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, të shërbimit dhe interesit të publikut. Megjithatë në të paktën 20 raste të evidencuara nga ana e Partisë Demokratike, deputetët, kandidatët për deputetë dhe Kryetarët e Bashkive promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale.
92. Promovimi i projekteve apo investimeve publike që do të kryhen në të ardhmen ka për qëllim të manipulojë vullnetin e zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar. Këtë mundësi sigurisht nuk ka se si ta ketë partitë opozitare. Në këtë kuptim, përdorimi i një mekanizmi të tillë nga ana e Partisë në pushtet, minon shanset e barabarta që duhet të kenë palët në garë. Megjithatë, përmasat reale të kësaj shkeljeje të Kodit Zgjedhor, e cila sigurisht cënon rëndë procesin zgjedhor, është e vështirë të përcaktohen me terma matematikorë, ajo duhet pasur parasysh në momentin e vlerësimit të tërësisë së shkeljeve të ligjit që kanë cënuar procesin në një masë të tillë, sa të ndikojnë drejtpërdrejtë në ndëryerjen e mandateve.
93. **Së dyti**, neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 6 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së përmbajnë rregullime të qarta sa i përket ndalimit të përdorimit apo detyrimit të administratës shtetërore për t'u përfshirë në fushatën zgjedhore në mbështetje të një kandidati apo partie politike. Megjithatë, gjatë gjithë fushatës u konstatuan raste të shumta, të denoncuar herë pas herë nga Partia Demokratike, se si të gjitha nivelet e administratës qendrore apo vendore ishin përfshirë në fushatë në mbështetje të kandidatëve të Partisë Socialiste. Nepunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra.

94. Në të paktën një rast, Partia Demokratike ka faktuar nepërmjet provave të pakundërshtueshme se administrata e OSHEH u vu në dispozicion të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste dhe më konkretisht
95. Ky shembull është ilustrim flagrant që tregon qartë sesi u shkinë strukturat shtetërore me ato partiake. Njëpunësit e administratës lokale dhe qendrore nuk konsiderohen nëpunës në shërbim të shtetit shqiptar, por si ushtarë që duhet t'i shërbejnë partisë, përndryshe i pret largimi nga puna. Këto shkelje flagrante të legjislacionit penal dhe zgjedhor, vecanërisht të dispozitave të sipërcuara, çënojnë rëndë procesin zgjedhor, pasi garën ndërmjet dy a më shumë subjekteve zgjedhore, e kthejnë në një garë ndërmjet shtetit dhe një partie politike. Është e kuptueshme se një garë e tillë, tërësisht e shpërpjestuar, ka një fitues të paracaktuar. Prandaj, edhe në këtë rast është e qartë se shkeljet e rënda dhe flagrante të ligjit, përkatësisht nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 6 të Vendimit nr. 9/20 të KQZ, kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor, dëmtojnë bazazinë ndërmjet palëve garuese dhe ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të Qarkut Elbasan dhe ndarjes së mandateve në këtë qark, duke plotësuar kështu kushtin e nenit 160 të Kodit Zgjedhor për konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve.
96. Së treti, neni 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1.3, gërma "d" i Vendimit Nr. 9/2020 ndalojnë punësimet në administratën publike në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve. Megjithatë, sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, midis tetmuorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind ose me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qanësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngushtshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet. Numri i saktë i të punësuarve në Qarkun e Elbasanit dhe sa prej pozicioneve të reja parashikohen të lidhen me këtë qark, do të dalë pas marrjes së provave gjatë hetimit administrativ, megjithatë është e qartë se kjo praktikë e qeverisë, si në Elbasan, ashtu edhe kudo tjetër ka pasur për qëllim që të ndikojë mbi vullnetin e zgjedhësve nëpërmjet ofrimit të përfitimeve të drejtpërdrejta.
97. Shifrati konkretë të të punonjësve shtesë të bashkisë Elbasan në kulmin e fushatës zgjedhore do të dalin pas marrjes së informacionit gjatë hetimit administrativ, megjithatë është e qartë se kjo shtesë punonjësisht është bërë në kuadër të fushatës zgjedhore, duke synuar shtimin e numrit të mbështetësve dhe votave për PS-në, në këmbim të vendit të punës. Këto shkelje

flagrante të Kodit Zgjedhor dhe akteve nenligjore të tij, që kanë synuar vazhdimisht të ndalojnë administratën të rrisë numrin artificialisht numrin e të punësuarve në kohë zgjedhore çdojnë rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë deformim të vullnetit të zgjedhësve, me ndikim të konsiderueshëm në rezultatin përfundimtar në zonën zgjedhore përkatëse, e për pasojë edhe në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, pasi të administrohen provat shtrëse që faktojnë përmasat reale të kësaj skeme të paligjshme në administratën qëndrore dhe bashkitë e Qarkut Elbasan, do të dalë qartë se hapja e vendeve të punës në administratën publike nga ana e Qeverisë Socialiste është një shkelje e rëndë e nenit 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1.3, gërma "c" i Vendimit Nr. 9/2020 e përmasave të tilla që ka ndikuar në shpërndarjen e mandateve për këtë qark. Kështu, duke qenë se përmbushet kushti i parashikuar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor, KAS-i duhet të vendosë konstatimin e paligjshmërisë, shpalljen e pavlefshmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve, me synim garantimin e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe të barabartë.

98. **Së katërti**, neni 3, pika 1.3, gërma "a" parashikon ndalimin e veprimtarive publike të cilat konsistojnë në shpërndarjen e lejeve të legalizimit në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. Megjithatë, siç kemi raportuar në pjesën e fakteve, Partia Demokratike disponon prova dhe foto të deputetëve të Partisë Socialiste, të cilët në të paktën 9 raste shpërndajnë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektoral. Ndërsa dy raste flagrante të denoncuar në SPAK nga PD dëshmojnë për përmasat reale të këtij problemi.
99. Nga të dhënat e mësipërme, kuptohet se bëhet fjalë për një numër shumë të madh kërkesash për leje legalizimi, rreth 160.000, të cilat aktualisht po trajtohen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për të gjithë vendin. Kjo do të thotë që impakti që ka ky proces në jetën e qytetarëve është shumë i madh. Ai lidhet me një nga të drejtat themelore që ka çdo qytetar, e drejta e pronës. Në këtë kuptim, përdorim i lejeve të legalizimit, qoftë dhënia e tyre apo shtyrja në kohë për t'ua refuzuar kërkesën eventualisht, përbën një shkelje skandaloze të ligjit. Kjo porosi e ardhur nga drejtuesi më i lartë i Agjencisë së Kadastrës dhe më pas e shpërndarë në mënyrë kapilare te drejtuesit vendore, tregon për përmasat reale që ka pasur ky fenomen përgjatë zgjedhjeve të 25 Prillit.
100. Numri i lejeve të legalizimit të shpërndarë në Qarkun Elbasan përgjatë periudhës zgjedhore, do të dalë nga provat e marra gjatë hetimit administrativ, por edhe me provat që ne kemi në dispozicion deri më tani provohet qartësisht se kjo veprimtari e paligjshme ka çenur rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar vullnetin e qytetarëve, e për pasojë rezultatin e zgjedhjeve dhe

ndarjen e mandateve. Ashtu, si shkeljet e tjera të analizuara më lart, edhe këto shkelje, duhen vlerësuar në tërësinë e tyre për pasojat e rënda që kanë sjellë mbi procesin zgjedhor, të cilat për nga ndikimi i tyre, e bëjnë procesin në tërësi të pavlefshëm dhe diktojnë përsëritjen e zgjedhjeve në kushte të ligjshme dhe të barabarta për të gjitha palët.

101. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u çënua rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Zyrat ektorale të Partisë Socialiste u kthyen në "institucione shtetërore" ku qytetarët duhet të paraqiteshin për t'u punësuar, për të marrë leje legalizimi, për të marrë dëshmipërbliimin nga tërmeti, celësat apo dokumentet e shtëpisë së ndërtuar etj. Shteti dhe Partia Socialiste, në koordinim dhe bashkëpunim me njëra-tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetërorë në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve. Projektet dhe investimet publike, shtëpitë e ndërtuara apo rindërtuara pas tërmetit, punonjësit e administratës, punësimet e reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë u vunë në dispozicion të plotë të Partisë, kryeministrit, ministrave dhe deputetëve, me qëllim për të fituar me çdo kusht zgjedhjet (shih fq. 2, 3 dhe 12 të Raportit Paraparak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe denuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, cka ka çënua rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Elbasanit.

102. Paligjshmëria e ngritur në sistem nga institucione, drejtues institucionesh, zyrtarë të lartë, përfaqësues të pushtetit qëndror dhe vendor, në bashkëpunim me elementë të krimit të organizuar, dikton domosdoshmërisht shpalljen e pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre në kushte normale në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ku palët garojnë në mënyrë të ndershme dhe të barabartë, ndërsa qytetarët mand të zgjedhin me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

A.3 Shkeljet ligjore lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale:

103. Neni 35 i Kushtetutës parashikon se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave mbi personin bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Neni 8 i

Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikon se “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij dhe familjare, banesës dhe korespondencës së tij”. Ndërsa, neni 6 i ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” parashikon se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, dhe neni 7 përcakton se ndalohej përpunimi i të dhënave sensitive ku përfshihen edhe mendimet politike, me përjashtim të rastit kur këtë e kërkon interesi publik.

104. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të 910 mijë votuesve, ku përfshihen të dhëna rejt personale si numri ID, vendbanimi, numri i telefonit, bindja politike, vendi i punës është në shkallë flagrante të dispozitave të sipërcituara. Origjina etnike, bindjet, anësia politike, ose pjesëmarrja në shoqata apo sindikata parashikohen edhe si të dhëna sensitive nga neni 3 § 2 i ligjit 9887 (shih edhe *Call k. Mbrojtës të Bashkuar f 112, dhe S. and Marper k. Mbledhës të Bashkuar f 66*). Këto shkallë të rënda të ligjit janë kryer nga drejtues, zyrtarë, përfaqësues dhe mbështetës të Partisë Socialiste, te ashtuquajturit “patronazhistë”, të cilët kryeministri në mënyrë të përsëritur i ka falënderuar për fitoren. Madje, pavarësisht se kjo skemë u zbulua plotësisht vetëm në Tiranë, kryetari i PS-së, Edi Rama dhe sekretari i përgjithshëm, Taulant Balla kanë pranuar se një skemë e tillë përdoret në të gjithë vendin nga strukturat e PS-së. Madje, ky i fundit ua dedikoi fitoren e madhe në Elbasan patronazhistëve të Qarkut, pasi sipas tij kjo fitore ishte tërësisht merita e tyre. Posedimi në mënyrë të paligjshme i të dhënave personale të qytetarëve, të marrë nga serverat shtetërore, i bëri zgjedhësit vulnerabël përballë pushtetit, duke i dhënë mundësi PS të ushtronte kontroll mbi këta zgjedhës (shih fq. 2 dhe 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR).

105. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se Partia Socialiste, drejtuesit, përfaqësuesit, strukturat, shërbet qëndrore, zyrat elektorale morën nga serverat shtetërore të dhënat personale të qytetarëve me qëllim përdorimin e tyre për t'i bërë qytetarët më vulnerabël dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Ky krim i shumëfishtë, me përmasa ndërkombëtare, përthen një rast flagrant se si shteti i vë në dispozicion Partisë infrastrukturën e tij për të fituar zgjedhjet. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave të 910 mijë qytetarëve në Tiranë dhe 350 mijë qytetarëve në Elbasan, për të cilat askush deri më sot nuk ka dalë të thotë që ka dhënë pëlqimin e tij për mbledhjen, përpunimin apo publikimin e tyre (shih *Rada v. Moldova, 2014*), pra në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, çenoi rëndë procesin zgjedhor të 25 Prillit.

106. Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe lëndjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabel përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht. Disa nga këto forma që përdori Partia Shtet ishte blerja e votuesve që mbështesnin opozitën, marrja e kartave të identitetit për të mos votuar, kërcënimt për të mos dalë në fushatë, apo kërcënime për largime nga puna të zgjedhësit apo të afërmit të tij, inspektime dhe paralajmërime për mbyllje biznesi. Te gjitha këto shkelje të rënda të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit Zgjedhor, ligju për mbrojtjen e të dhënave personale, cënuan rëndë procesin zgjedhor të 25 prillit, duke ndikuar drejtpërdrejtë mbi rezultatin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, në shkelje flagrante të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Për këtë shkak, i vetmi mjet ligjor për të garantuar rikthyer besimin e qytetarve të sistemi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është përsëritja e tyre në këtë zonë zgjedhore.

A.4 Shkeljet ligjore lidhur me mohimin e të drejtës për të votuar të emigrantëve:

107. E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila citon se: *"1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet."* Ndërkaq ajo është edhe një nga të drejtat themelore të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht e parashikuar në nenin 3, Protokollit 1 i cili citon se: *"Palet e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjet e organit legjislativ."*
108. Ashtu sic kemi përmendur edhe në rrethanat e çështjes të këtij ankimi, në datën 19 Prill 2021, me anë të Urdhërit nr. 219 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Civile kjo e fundit urdhëroi të gjithë shtetasit që hyjnë në Shqipëri përmesë rrugëve ajërore, tokësore dhe detare nga këto dy shtete të vetëkarantinoohen në mënyrë të detyrueshme nga data 20 Prill 2021 deri në datën 03.05.2021. Pra vetëm 6 ditë përpara organizimit të zgjedhjeve, shtetasit shqiptar të cilët vendbanojnë në Maqedoni dhe Greqi u ndaluan nga marrja pjesë në zgjedhje. Në total, sipas të dhënave të institutit për vitin 2020, në Greqi dhe Maqedoni banojnë rreth rreth 500,000 votues (pra të moshave mbi 18 vjeç).

109. Praktika gjyqësore e GJEDNJ, përkatësisht vendimet si *Hrist v. Mbrojtëria e Bashkuar, Aziz v. Qipri, Tanase v. Moldavia, Libito v. Italy, Sitaropoulos dhe të tjerë v. Greqi*, etj., në lidhje me votimin e emigrantëve jashtë kufijve ka vendosur dy parime kryesore si vijon: (i) E drejta e emigrantëve për të votuar në vendin e tyre të rezidencës nuk është një detyrim që lind nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës por ky i fundit mund të jetë i aplikueshëm vetëm nëse ka një detyrim tibi shtetit që buron nga ligji i brendshëm (ii) Gjykata është në vecanti e vëmendëshme për rastet kur është mohuar e drejta e votës në tërësi. Ky kufizim absolut duhet të arrijë një qëllim të ligjshëm (legitimate aim) por gjithashtu të kalojë testin e proporcionalitetit (stringent proportionality test)?.
110. Në rastin e Shqipërisë, në shresë të nenit 45 të Kushtetutës, neni 24 dhe 25 i Kodit Zgjedhor, sipas ndryshimeve të fundit të datës 23.07.2020, ka parashikuar shprehimisht të drejtën e votimit për emigrantët shqiptarë në vendin e tyre të rezidencës. Kështu, garantimi i kësaj të drejte për të gjithë emigrantët është një detyrim, i cili buron nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor dhe për rrjedhojë në referim të parimit të parë relativuar më sipër, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar në vendin e tyre të rezidencës është një shkelje e nenit 45 të Kushtetutës, neneve 24, 25 të Kodit Zgjedhor dhe rrejdhimisht edhe e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Nga ana tjetër, persa i parimit të dytë të gjyktës në çështjen *Sitaropoulos dhe të tjerë*, kjo e fundit argumentoi se kufizimi që emigrantët të votojnë në Greqi dhe jo nga vendi i tyre i rezidencës ishte një kufizim proporcional dhe e drejta e tyre nuk u mohua në tërësinë e saj.
111. **Konkluzion:** Në zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, është e qartë se jo vetëm nuk lejohen shtetasit shqiptarë me rezidencë jashtë Shqipërisë që të votojnë në vendbanimin e tyre (detyrim ky ligjor sic e kemi analizuar edhe më sipër), por efektivisht e drejta për të votuar të shtetasve shqiptarë resident në Greqi dhe Maqedoni është mohuar në tërësinë e saj pasi këta të fundit për shkak të karantinimit të detyruar nuk u lejuan që të votojnë as duke u kthyer perkohësisht në Shqipëri. Kështu, një masë e tillë është tërësisht jo proporcionale dhe në shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Këto shkelje të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që sollën mohimin e të drejtës për të votuar të rrebi 500 mijë qytetarëve me të drejtë vote. Diferenca në përqindje ndërmjet subjekteve zgjedhore është shumë herë më e ulët se përqindja e votuesve që jetojnë jashtë vendit apo vecanërisht në Greqi/Maqedoni të Veriut, të cilëve u mohua e drejta për të votuar. Kjo çoi në rëndë procesin zgjedhor në tërësinë e tij, dhe sigarisht me një impakt të drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve, pasi rrebi 500 mijë zgjedhës

potencialë, mund të kishin përcaktuar jo vetëm rezultatit në zonën zgjedhore të Qarkut Elbasan, por në të gjithë Shqipërinë.

A.5 Shkeljet ligjore lidhur me mohimin e të drejtës për të votuar të infektuarve me COVID-19

112. Ashtu siç është shpjeguar më lart, neni 45 i Kushtetutës dhe neni 3, Protokolli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut garantojnë të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur të çdo shtetasi që ka mbushur moshën madhore. Rastet e vetme përjashtimore nga kjo e drejtë janë parashikuar shprehimisht nga neni 45 i Kushtetutës, përkatësisht shtetasit e deklaruar të paafte, shtetasit e dënuar me burgim për një kategori krimesh, shtetasit e dënuar për një krim ose cënim shumë të rëndë të sigurisë publike. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor nuk parashikon përjashtime të tjera nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
113. Në rastin konkret, personave të infektuar me COVID-19 iu mohua e drejta për të votuar për shkak të detyrimit për të qëndruar të karantinuar. Asnjë mundësi alternative nuk u parashikua për këta persona, qoftë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve apo Ministria e Shëndetësisë, duke sjellë kështu cënimin e të drejtës së tyre. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte 22.431 persona.
114. **Konkluzion:** Mohimi kategorikisht i të drejtës për të votuar i personave të infektuar me COVID-19 përbën efektivisht shkelje të së drejtës së tyre. Siç ka konkluduar Misioni i OSBE/ODIHR në raportin e tij paraprak kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagën të vitit 1990 të OSBE-së (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR). Ashtu si edhe në rastin e emigrantëve është e qartë se këto cënime të rënda të procesit zgjedhor mund të ndryshojnë vetëm me një vendimmarje pavlefshmërie dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Tejt atyre parashikimeve që përmban Kushtetuta dhe ligji, askujt tjetër nuk mund t'i mohohet e drejta thelbësore për çdo shoqëri demokratike, për të zgjedhur përfaqësuesit e tij/saj. Mohimi tërësisht i të drejtës së këtyre qytetarëve për të votuar përbën një shkelje të rëndë të ligjit, e cila në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ka ndikim në rezultatit e zgjedhjeve dhe në ndarjen e mandateve. Për triedhjetë, zgjedhjet në këtë zonë zgjedhore duhet të shpallen të pavlefshme dhe të përsëriten.

A.6 Shkeljet ligjore lidhur me pavlefshmërinë e fletëve të votimit dhe diskriminimin e kandidatëve:

115. **Së pari**, neni 98 i Kodit Zgjedhor parashikon se fleta e votimit duhet të respektojë kushtin që fleta e votimit të mos jetë tejet e ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Ndërsa, pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias parashikon se zgjedhësit duhet të kenë mundësi të hedhin votat e tyre për listat e regjistruara ose për kandidatët, gjë që do të thotë se atyre duhet t'u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve, dhe ata duhet të kenë mundësi të hedhin fletët e votimit në kutitë e votimit.
116. Në fakt, ashtu siç kemi relatuar në pjesën e fakteve, në datën 31 Mars, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi fletën e votimit me emrat e kandidatëve për deputetë, në përputhje me parimet e neni 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 27 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore për të mundësuar orientimin sa më të lehtë të votuesve për të votuar subjektin zgjedhor që dëshironin dhe kandidatin e preferuar. Por, ky vendim u ndryshua nga KAS-i dhe Kolegji Zgjedhor, cka solli që numri i fletëve të votimit të pavlefshme të arrijtë në 83.028 vota ose 5% e numrit total të votuesve dhe ku vetëm në Elbasan një numër prej 7808 vota të pavlefshme. Ky fakt u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODHIR sipas të cilit konfigurimi i fletës së votimit kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve (shih fq. 7). Por, edhe në deklaratën e datës 28 Prill, Komisioneri Shtetëror pranoi se fleta e votimit kishte ndikuar në një numër shumë të lartë fletësh të pavlefshme.
117. **Së dyri**, neni 18 parashikon se të gjithë janë të drejtë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet pa një shkak të përligjur. Ndërsa, neni 45 garanton në mënyrë të barabartë të drejtën për t'u zgjedhur të cdo shtetasi të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, dhënia të drejtë vetëm e kryetarëve të partive për të kandiduar në katër zona zgjedhore, përbën një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara. Ky fakt është konstatuar me të drejtë edhe nga raporti paraprak i OSBE/ODHIR, i cili shprehet se ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih fq. 3).

118. **Konkluzion:** Nga sa më lart, është e qartë se miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përktuhyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet paleve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka votim katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë. Nga ana tjetër, lejimi vetëm i kryetarëve të partive për kandiduar në kater zona zgjedhore, të cilat në lista janë të harabardë si të gjithë kandidatët e tjerë, përben një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.
119. Në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërpjthje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Elbasan duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të anulohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.

A.7 Shkeljet ligjore lidhur me votimin e dyfishtë, votimin për të tretët apo votimin familjar:

120. Siç kemi relatuar në kapitullin e rrethanave të cështjes, fotja e identifikimit elektronik në Kodin Zgjedhor dhe aplikimi për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 kishte si qëllime të qarta eliminimin e votimit të dyfishtë, votimit për të tretët apo votimin familjar. Votimi i dyfishtë nënkupton se i njëjti zgjedhës voton më shumë se një herë në të njëjtën qendër votimi apo qendra votimi të ndryshme. Votimi për të tretët, në kuptim të nenit 2, pika 29 e Kodit Zgjedhor, nënkupton rastet kur një zgjedhës voton në emër dhe për llogari të një zgjedhësi tjetër, i pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Ndërsa, votimi familjar, sipas nenit 2, pika 30 e Kodit Zgjedhor, nënkupton rastet kur një pjesëtar i familjes, voton në emër dhe për llogari të pjesëtarëve të tjerë.
121. Të vetmet raste kur votimi për të tjerë është i lejuar, qofshin familjarë ose jo, janë ato të parashikuara nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, kur zgjedhësi vetë është në pamundësi fizike për

të ushtruar të drejtën e votës. Në këtë rast, ky zgjedhës mund të asistohet nga një familjar ose zgjedhës tjetër, votues në të njëjtën qendër votimi, për të votuar, duke nënshkruar një deklaratë të posacme. Pra, rastet kur një zgjedhës voton në emër të një zgjedhësi tjetër, në kushtet e nenit 108 sipërcituar, dokumentohen dhe mund të provohen lehtësisht. Në të gjitha rastet e tjera, votimi i dyfishtë, për të tretët apo familjarët, përveçse në kundërshtim flagrant me nenin 3, pika 4 që parashikon të drejtën e çdo zgjedhësi vetëm për një votë, përbën edhe vepër penale, të parashikuara nga neni 327/a të Kodit Penal.

122. Megjithatë, ashtu siç kemi parashtruar në pjesën e faktive, nga informationet e marra në terren nga strukturat e PD-së rezultoi se persona të ndryshëm kanë votuar më shumë se një herë, qoftë për të tretët apo familjarë të tyre, duke shkelur kështu drejtpërdrejtë Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij problemi u pramua edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në datën 6 maj njoftoi fillimin e procesit të kryqëzimit të dhënave për të konstatuar rastet e votimit më shumë se një herë në një qendër votimi apo qendra të ndryshme. Përmasat reale në numër zgjedhësish në zonën zgjedhore të Qarkut të Elbasanit do të dalin nga provat e kërkuara gjatë hetimit administrativ nga ana jone. Thënë këtë, votimi i dyfishtë, votimi për të tretët ose familjarët, përbën shkelje të rëndë të ligjit, duke cënuar procesin zgjedhor në atë masë sa që mund të ndikojë në ndarjen e mandateve. Votimi i një personi në emër të tretëve apo familjarëve i bën zgjedhjet e pavlefshme. Votimi i një personi për të tjerët cënon parimin e votës vetjake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës (shih Vendimin nr. 169, datë 26.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese). Nëse gjatë hetimit administrativ rezultoi se ky problem ekziston në një masë të gjërë apo minimalisht mbi 136 raste, atëherë KAS-it nuk i mbetet tjetër, veçse shpallja e pavlefshmërisë dhe urdhërimi i përsëritjes së zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku i Elbasanit.

B. Në lidhje me provat që kërkojnë të merren:

123. Pjesa X, nenet 124 – 144 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë procedurën që mbljek Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e një ankimi administrativ. Neni 136, pika 1, gërma “c” parashikon se palët kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre. Ndërsa, pika 3 përcakton se kërkesa për marrjen e provave, sipas shprehjes “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-

ja, pranohet menjëherë pa in nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara. Neni 137 përcakton detyrimin që kanë organt e tjera të administratës publike për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose cmohet e nevojshme për hetimin administrativ. Ndersa, neni 138 përcakton se KQZ-ja, kur pranon kërkesën e paleve sipas nenit 136, pika 3 të Kodit, keqyr materialet zgjedhore në kutitë e materialeve të votimit dhe kutitë e fletëve të votimit. Nëse kërkohet nga një anetar i KQZ si, kjo e fundit është e detyruar të kryejë numërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit.

124. Në rastin konkret, për të provuar pretendimet e parashtruara më lart lidhur me tërësinë e shkeljeve ligjore që çojnë në pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Elhasan, në vijim do të parashtrojmë kërkesat tona për marrjen e provave në përputhje me nenet 136, 137 dhe 138 të Kodit Zgjedhor, si më poshtë:

- (i) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore dhe fazën e tyre;
- (ii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Përgjithshme për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore në prokuroritë e rretheve dhe fazën e tyre;
- (iii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore;
- (iv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit mbi gjendjen e rezervave të shtetit në depozitat qendrore dhe lokale për çdo muaj nga Dhjetor – Maj 2021;
- (v) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Inspektorati Qëndror dhe të gjitha inspektoriatet që veprojnë në Shqipëri për numrin e inspektimeve të kryera në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021; për numrin e gjobave dhe sanksioneve të vendosura; numrin e sanksioneve/gjobave të revokuara me vendim administrativ/vendim gjyqësor;
- (vi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia e Prokurimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve, PPP ve të shpallur rishrazi apo për të cilat janë shpallur finasit në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;

- (vii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Këshilli Kombëtar i Territorit për numrin e lejeve të ndërtimit të dhëna në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (viii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për numrin e lejeve të legalizimit të dhëna sipas qarqeve në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (ix) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministri i Shetit për Rindërtimin për numrin e banesave të ndërtuara/rindërtuara, për të cilat janë dhënë cesat e banesave në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (x) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbi numrin e shtetasve shqiptarë që ndryshuan adresat e banimit në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Departamenti i Administratës Publike për numrin e punonjësve të institucione publike, vendore apo qendrore, dhe si ka ndryshuar, sipas qarqeve, për periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga 61 bashkitë e vendit, agjencitë e varësisë dhe shoqëritë në pronësi të shtetit apo bashkive, për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qendrore, dhe si ka ndryshuar, për periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xiii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 61 bashkitë e vendit lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe ndryshimin e masës ekonomike, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xiv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministri i Shetit për Rindërtimin dhe bashkitë Elbasan, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vlorë, Krupë, Lac dhe Mirditë për shpërblimet e dhëna familjeve të prekura nga tërmeti, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar lidhur me fazën e hetimeve lidhur me hërjet publike të të dhënave të 910 mijë qytetarëve të Tiranës;
- (xvi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga INSTAT mbi numrin e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë; numrin e shqiptarëve që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut; dhe numrin e këtyre shtetasve mbi moshën 18-vjeç;

- (xvii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë mbi numrin e personave të infektuar me COVID-19 në datën 25.04.2021 sipas qarqeve;
- (xviii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi numrin e shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën 19.04.2021 – 25.04.2021 nga Republika e Greqisë dhe Maqedonia e Veriut; listën e plotë të këtyre personave;
- (xix) Marrjen e një informacioni zyrtar nga OSHRE mbi të gjitha shpërblimet që u janë punonjësve të kësaj kompanie shtetërore, sipas qarqeve, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xx) Marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore Qarku i Elbasanit.

IV. KONKLUZIONI

125. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, si dhe:

- (i) Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ mer vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitetin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se siç kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga PD-ja përmbush të tre kritieret proceduriale (legjitimitetin, kompetencën dhe afatin ligjor), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve;
- (ii) Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në mënyrë kapitale në të gjithë Qarkun e Elbasanit për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve.
- (iii) Parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënuar rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkruanë në një. Zyrat elektorale të Partisë Socialiste u kthyen në “institucione shtetërore” ku qytetarët duhet të paraqiteshin për t’u punësuar, për të marrë leje legalizimi, për të marrë dëmshpërblimin nga tëmci, celësat apo dokumentet e shtetësisë së ndërtuar etj. Shteti dhe Partia Socialiste, në koordinim dhe bashkëpunim me njëra-tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetërorë në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve. Projektet dhe investimet publike, shtëpitë e ndërtuara apo

rindërtuara pas tërmetit, punonjësit e administratës, punësimet e reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë u vunë në dispozicion të plotë të Partisë, kryeministrit, ministrave dhe deputetëve, me qëllim për të fituar me çdo kusht zgjedhjet (shih fq. 2, 3 dhe 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR);

- (iv) Partia Socialiste, drejtuesit, përfaqësuesit, strukturat, shtabet qendrore, zyrat elektorale morën nga serverat shtetërorë të dhënat personale të qytetarëve me qëllim përdorimin e tyre për të bërë qytetarët më vulnerabel dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Ky krim i shumefishtë, me përmasa ndërkombëtare, përbën një rast flagrant se si shteti i vë në dispozicion Partisë infrastrukturën e tij për të fituar zgjedhjet. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave të 910 mijë qytetarëve në Tiranë dhe 350 mijë qytetarëve në Elbasan, për të cilat askush deri më sot nuk ka dale të thotë që ka dhënë polqimin e tij për mbledhjen, përpunimin apo publikimin e tyre, pra në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, çënoi rëndë procesin zgjedhor të 25 Prillit;
- (v) Në zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, është e qartë se jo vetëm nuk lejohen shtetasit shqiptar me rezilencë jashtë Shqipërisë që të votojnë në vendbanimin e tyre, por efektivisht e drejta për të votuar të shtetasve shqiptarë resident në Greqi dhe Maqedoni është mohuar në tërësinë e saj pasi këta të fundit për shkak të karantinimit të detyruar nuk u lejuan që të votojnë as duke u kthyer përkohësisht në Shqipëri. Kështu, një masë e tillë është tërësisht jo proporcionale dhe në shkelje të nenit 3 të Protokolli nr. 1. Këto shkelje të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që sollën mohimin e të drejtës për të votuar të mbi 500 mijë qytetarëve me të drejtë vote. Diferenca në përqindje ndërmjet subjekteve zgjedhore është shumë herë më e ulët se përqindja e votuesve që jetojnë jashtë vendit apo veranërisht në Greqi/Maqedoni të Veriut, të cilëve iu mohua e drejta për të votuar;
- (vi) Mohimi kategorikisht i të drejtës për të votuar i personave të infektuar me COVID-19 përbën efektivisht shkelje të së drejtës së tyre. Sic ka konkluduar Misioni i OSBE/ODIHR në raportin e tij paraprak kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për drejtat e votimit dhe hartimin e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR);

- (vii) Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë. Vecanërisht e vërtetë është kjo për Qarkun e Elbasanit ku diferenca ndërmjet PS dhe LSI ishte 136 vota për mandatin e deputetit, ndërsa numri i votave të pavlefshme është 7808 vota;
- (viii) Në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit – shithlerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga PS, përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota – cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga nenet 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Elbasanit.

126. Bazuar në nenin 45 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 3, Protokoli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore dhe nenet 143, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht,

KËRKOJME

1. Pranimin e ankimit për kundërshtimin e Vendimit Nr. 344, datë 04.05.2021 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhese për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Elbasan.

3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Elbasan, në periudhën më të afërt zgjedhore.

Me konsideratë,

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Ivi KASO

T / Mergim Fajzi
Engell



Bashkëlidhur gjeni provat:

- (i) Prova Nr. 1 – Fotografi të Asitit Sufalit;
- (ii) Prova Nr. 2 – Deklarata e Kryeprokurorit Olsian Çela nga Elbasani;
- (iii) Prova Nr. 3 – Kur Suel Çela mbledhte vota për Qazim Sejdimin...me kallash në kokë!
;
- (iv) Prova Nr. 4 – Hiqe skandali/ Prokurori që heron grabitjen në Rinas, vëllai i këshilltarit të Balles;
- (v) Prova Nr. 5 – Denoncimi/ Drejtoresha e spitalit të Elbasanit kërkon 4—5 mijë euro rryshfet për një vend pune
- (vi) Prova Nr. 6 – Nga Jurgis Gyrbja, Rrahman Rrahja te djalë i Aqif Rakipit, ja kush fshihet në lista e PS. Socialistët kandidojnë edhe...;
- (vii) Prova Nr. 7 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike i datës 23.02.2021;
- (viii) Prova Nr. 8 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike i datës 07.04.2021;
- (ix) Prova Nr. 9 – Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, deklarata për ngjarjen e djeshme në Elbasan;
- (x) Prova Nr. 10 – Bllok “pagesash” dhe karta ID: Si u manipulua përplasja e përgjakshme e Elbasanit;
- (xi) Prova Nr. 11 – Denoncimi/Si i bleu Ardian Ceta me nga një rroge shpërblym punonjësit e OSHEE;
- (xii) Prova Nr. 12 - Vendimi Nr. 1044/2020 i Këshillit të Ministrave;
- (xiii) Prova Nr. 13 – Vendimi Nr. 1076/2020 i Këshillit të Ministrave;
- (xiv) Prova Nr. 14 – Vendimi Nr. 1102/2020 i Këshillit të Ministrave;
- (xv) Prova Nr. 15 – Fotografi nga zyrtarët socialistë.
- (xvi) Prova Nr. 16 – Screenshot nga EhbatsApp Group i OSHEE Elbasan;
- (xvii) Prova Nr. 17 – Kryeministri në Elbasan për ditën e Verës, simpatizantët e PD: Rama ik;
- (xviii) Prova Nr. 18 – Sherr mes qytetarëve të mbledhur për të festuar në Elbasan: mbështetësit të dy paleve konfliktohen verbalisht në Bulevard;
- (xix) Prova Nr. 19 – Elbasan/ Konflikt fizik mes kandidatit Luciano Boçi dhe biznesmenit Gjergj Luca;
- (xx) Prova Nr. 20 – Kandidati i PD kërcënohet me jetë nga bandat e Rilindjes në Elbasan;

- (xxi) Prova Nr. 21 – Të dhënat e INSTAT për punësimet në tremujorin e 3 dhe 4 të vitit 2020;
- (xxii) Prova Nr. 22 – Qeveria hap 2.472 vende të reja pune;
- (xxiii) Prova Nr. 23 – Foto dhe video nga shpërndarja e lejeve të legalizimit nga kandidatë për deputetë të PS-së;
- (xxiv) Prova Nr. 24 – “T’i mbajmë njerëzit vartur”/Gazetari Artan Hoxha publikon audio-regjistrimin e Kreut të Kadasitës! Artan Lami: S’duhet t’i themi që shtëpia jonë nuk legalizohet;
- (xxv) Prova Nr. 25 – Skandal/Publikohen të dhënat personale të 910 mijë votuesve në Tiranë;;
- (xxvi) Prova Nr. 26 – Database të të dhënave të PS ekzistojnë në çdo qark të Shqipërisë;
- (xxvii) Prova Nr. 27 – Rama me të rinjtë dhe të rejar në Durrës, falenderon “patronazhistet”: Punojnë vulnetarisht, jemi parti e mirëorganizuar;
- (xxviii) Prova Nr. 28 – Balla: Patronazhistët na kanë mundur rezultat më të lartë në Elbasan në 30 vite;
- (xxix) Prova Nr. 29 – Vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për karantinën e emigrantëve nga Greqia;
- (xxx) Prova Nr. 30 – Shfuqizohet vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për karantinën e emigrantëve;
- (xxxi) Prova Nr. 31 – Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 31.03.2021 për miratimin e fletëve të votimit;
- (xxxii) Prova Nr. 32 – Vendim i KAS për miratimin e fletëve të votimit me numra, datë 03.04.2021;
- (xxxiii) Prova Nr. 33 – Vendim i Kolegjit Zgjedhor, datë 04.04.2021, për lënien në fuqi të vendimit të KAS;
- (xxxiv) Prova Nr. 34 – Letra e kompanisë Celrics për prodhimin e fletëve të votimit;
- (xxxv) Prova Nr. 35 – Të dhënat e KQZ;
- (xxxvi) Prova Nr. 36 – Deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 28.04.2021.